



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.19/2026

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj, kryesuese, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e OJQ Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.01/1198/2026 të datës 03.06.2026, lidhur me Miratimin e Rekomandimit për Lejimin e Votimit me Dokumente të Republikës së Kosovës me afat të skaduar të vlefshmërisë për votim në Qendrat e Votimit në Përfaqësitë Diplomatike në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen me date 07 Qershor 2026, në seancën e panelit të mbajtur me datë 05.06.2026, mori këtë:

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e parashtruar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) me numër ZP.Anr.19/2026, **ANULOHET** vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.01/1198/2026 i datës 03.06.2026, lidhur me Miratimin e Rekomandimit për Lejimin e Votimit me Dokumente të Republikës së Kosovës me afat të skaduar të vlefshmërisë për votim në Qendrat e Votimit në Përfaqësitë Diplomatike.

A r s y e t i m

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), brenda afatit ligjor, ka paraqitur ankesë në PZAP me datë 04.06.2026, kundër Vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve Nr. 01/1198-2026, të datës 03.06.2026, me të cilin është miratuar rekomandimi për lejimin e votimit me dokumente identifikimi të Republikës së Kosovës me afat të skaduar të vlefshmërisë në qendrat e votimit në përfaqësi diplomatike.

Në ankesë pretendohet se vendimi i kontestuar është nxjerrë në kundërshtim me Ligjin Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, përkatësisht me nenin 90 të tij, i cili përcakton se votuesi mund të votojë vetëm nëse identifikohet saktësisht në Listën e Votuesve dhe ofron njërin prej dokumenteve të vlefshme të identifikimit të lëshuara nga Republika e Kosovës.

Ankuesi pretendon se KQZ, përmes vendimit të kontestuar, ka ndryshuar përmbajtjen e dispozitës ligjore duke lejuar përdorimin e dokumenteve me afat të skaduar, ndonëse ligji kërkon dokumente të vlefshme identifikimi. Sipas ankuesit, KQZ nuk ka kompetencë që përmes një vendimi administrativ të ndryshojë apo zgjerojë kushtet ligjore për ushtrimin e së drejtës së votës dhe se një veprim i tillë përbën tejkalim të kompetencave të saj ligjore dhe cenim të parimit të ligjshmërisë. Ankuesi ka theksuar se çdo ndryshim i kushteve të përcaktuara me ligj mund të bëhet vetëm nga ligjvënësi dhe jo nga organi përgjegjës për administrimin e zgjedhjeve.

Në përgjigjen ndaj ankesës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka propozuar refuzimin e ankesës si të pabazuar. KQZ ka theksuar se vendimi i kontestuar nuk ka krijuar të drejtë të re vote dhe nuk ka zgjeruar kategorinë e votuesve që gëzojnë të drejtën e votës, por ka pasur për qëllim garantimin e ushtrimit efektiv të së drejtës kushtetuese të votës nga shtetasit e Republikës së Kosovës të regjistruar për votim në përfaqësi diplomatike.

Sipas KQZ-së, gjatë procesit të regjistrimit të votuesve jashtë Kosovës janë pranuar dokumente të identifikimit me afat të skaduar për qëllime të verifikimit të identitetit dhe regjistrimit në Listën e Votuesve. KQZ ka argumentuar se dokumenti i skaduar vazhdon të dëshmojë identitetin e personit dhe se vendimi i kontestuar nuk ka ndryshuar kushtet ligjore për të drejtën e votës, por vetëm ka mundësuar identifikimin e votuesve të regjistruar paraprakisht.

KQZ më tej ka pretenduar se vendimi është marrë në përputhje me kompetencat e saj kushtetuese dhe ligjore për administrimin e procesit zgjedhor, duke u mbështetur në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe në Rregulloren Zgjedhore Nr. 04/2025 për Regjistrimin dhe Votimin Jashtë Kosovës, si dhe në Rregulloren Nr. 01/2026 për ndryshimin dhe plotësimin e saj. Sipas KQZ-së, vendimi është në funksion të mbrojtjes së të drejtës së votës dhe është në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe standardet demokratike për pjesëmarrje në zgjedhje.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, konstatoi se:

-Ankesa është e bazuar

Paneli, pasi shqyrtoi pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, vendimin e kontestuar dhe shkresat e tjera të lëndës, gjeti se ankesa është e bazuar.

Paneli ka gjetur se në shkresat e lëndës rezulton se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 01/1198/2026, të datës 03.06.2026, ka miratuar rekomandimin për lejimin e votimit me dokumente të Republikës së Kosovës me afat të skaduar të vlefshmërisë për votim në qendrat e votimit në përfaqësi diplomatike.

Sipas vlerësimit të panelit KQZ nuk ka pasur autorizim ligjor që përmes vendimit administrativ, votuesve jashtë Kosovës të ju lejojë votimin me dokument identifikimi të skaduar, në një situatë kur Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme kërkon shprehimisht paraqitjen e dokumenteve të vlefshme të identifikimit. Konkretisht neni 90 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme përcakton se, për qëllim të zgjedhjeve, shtetasi me të drejtë vote brenda vendit dhe në përfaqësi diplomatike mund të votojë nëse identifikohet saktësisht në Listën e Votuesve dhe ofron njërin prej dokumenteve të vlefshme të identifikimit të lëshuara nga Republika e Kosovës, përkatësisht letërnjoftimin, pasaportën ose lejen e vozitjes.

Paneli vlerëson se kjo dispozitë është e qartë dhe nuk lejon dualizem në interpretim që do ta barazonte dokumentin e vlefshëm me dokumentin me afat të skaduar. Në këtë rast ligji nuk ka përdorur vetëm termin “dokument identifikimi”, por shprehimisht ka kërkuar “dokumente të vlefshme të identifikimit”. Prandaj, vlefshmëria e dokumentit nuk është vetëm element formal i parëndësishëm, por një kusht ligjor për identifikimin e votuesit në ditën e votimit dhe dhënies se mundësisë për te votuar.

Ne përgjigjen e dhënë KQZ ka theksuar se gjatë fazës së regjistrimit të votuesve jashtë Kosovës, ka lejuar që aplikues të caktuar të regjistrohen duke paraqitur dokumente të identifikimit me afat të skaduar. Mirëpo PZAP vlerëson se kjo rrethanë në asnjë mënyrë nuk mund të interpretohet me automatizem si e drejtën për të votuar me dokument të skaduar në ditën e votimit. Nga se procedura e regjistrimit të votuesve dhe procedura e votimit janë dy faza të ndryshme të procesit zgjedhor. Regjistrimi ka për qëllim verifikimin paraprak të të drejtës së një personi për t’u përfshirë në Listën e Votuesve, ndërsa votimi është faza përfundimtare e ushtrimit të së drejtës së votës, ku ligji kërkon identifikim me dokument të vlefshëm të votuesit në momentin e paraqitjes në vendvotim ditën e votimit, pavarësisht se ku voton votuesi, brenda apo jashtë vendit.

PZAP vlerëson se përfshirja e një personi në Listën e Votuesve nuk e përjashton detyrimin që ai person, në ditën e votimit, t’i plotësojë kushtet e përcaktuara shprehimisht me ligj. Regjistrimi me dokument të skaduar mund të ketë vlejtur vetëm për qëllime të shqyrtimit të aplikimit dhe verifikimit paraprak, me qëllim të dhënies se mundësisë për qenë në listën e votuesve, por nuk mund të ketë efektin e ndryshimit apo shmangies së kërkesës ligjore të dispozitës së nenit 90 të LZP-se për dokument të vlefshëm identifikimi gjatë votimit.

Paneli vlerëson se pretendimi i paraqitur në përgjigjen e KQZ-së se dokumenti i skaduar ende mundëson identifikimin e personit, nuk është i mjaftueshëm për të shmangur kërkesën ligjore të përcaktuar shprehimisht në dispozitën ligjore të nenit 90 të LZP-se. Edhe nëse dokumenti i skaduar përmban të dhëna personale, fotografi dhe numër personal, ligji qartë ka kërkuar jo vetëm identifikim faktik përmes fotografisë, por identifikim përmes dokumentit të vlefshëm gjë që KQZ nuk mund ta anashkalojë dispozitën ligjore të lartcekur duke zëvendësuar këtë standard ligjor me një vendim administrativ.

Paneli vlerëson se është në mandatin e KQZ-se që të organizojë dhe administrojë procesin zgjedhor, të nxjerrë rregulla dhe të marrë vendime për zbatimin e ligjit, mirëpo KQZ nuk ka diskrecion të ndryshojë kushtet ligjore për ushtrimin e së drejtës së votës, e as të krijojë përjashtime, apo të krijoj standarde që nuk janë paraparë sipas ligjit.

E drejta e votës është e drejtë kushtetuese me rëndësi të veçantë, por ushtrimi i saj duhet të bëhet në mënyrën e përcaktuar me ligj. Lehtësimi i ushtrimit të kësaj të drejte nuk mund të bëhet duke anashkaluar një kërkesë të qartë ligjore. Nëse konsiderohet se për votuesit jashtë vendit duhet të parashihet mundësia e votimit me dokumente të skaduar, një përjashtim i tillë duhet të përcaktohet nga autoriteti kompetent dhe jo nga KQZ përmes vendimit administrativ.

Përves kësaj, Paneli vlerëson se vendimi i kontestuar krijon një standard të veçantë identifikimi vetëm për votuesit në përfaqësi diplomatike, ndonëse neni 90 i LZP nuk bën dallimin ndërmjet votuesve që votojnë brenda ose jashtë Kosovës. Duke qenë se ligji kërkon paraqitjen e dokumenteve të vlefshme të identifikimit për të gjithë votuesit, KQZ nuk ka pasur kompetence

te krijoje përjashtim vetëm për një kategori te caktuar te votuesve pa –pasur baze të qartë ligjore.

Andaj Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi konform neneve: 53 paragrafi 1, Neni 132 paragrafi 4, të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili shprehimisht parasheh “Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që ka kompetenca të nxjerrë aktin, nga organi i tij mbikëqyrës apo nga një organ tjetër i përcaktuar shprehimisht me ligj”, neni 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili shprehimisht parasheh se: “Nëse organi epror vlerëson se ankesa është e pranueshme dhe e bazuar, ai duhet të vendosë përfundimisht me një akt të ri që të anulojë apo ndryshojë, plotësisht apo pjesërisht, aktin e ankimuar, gjegjësisht do të nxjerrë aktin e kërkuar nga pala.”

Nga këto arsye, Paneli e aprovon ankesën si të bazuar dhe anulon vendimin nr. 01/1198/2026 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të datës 03.06.2026.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZP.Anr.19/2026, datë 05.06.2026

Kryesuese e Panelit

Kymete Kicaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas neni 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

AA.nr.26/2026

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Delushe Halimi, kryetare, Faton Ademi dhe Franciska Zhitija - Ymeri anëtarë, duke vendosur në çështjen juridike sipas ankesës së Violeta Salihu, nga Prishtina, anëtare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, e parashtruar kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) ZP.Anr.19/2026 i datës 05.06.2026, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 11.06.2026, mori këtë:

A K T V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa e parashtruar nga Violeta Salihu, nga Prishtina, anëtare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) ZP.Anr.19/2026 i datës 05.06.2026.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZP.Anr.19/2026, të datës 05.06.2026, është vendosur: Aprovohet si e bazuar ankesa e parashtruar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) me numër ZP.Anr.19/2026, anulohet vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) Nr.01/1198/2026 i datës 03.06.2026, lidhur me Miratimin e Rekomandimit për Lejimin e Votimit me Dokumente të Republikës së Kosovës me afat të skaduar të vlefshmërisë për votim në Qendrat e Votimit për Përfaqësitë Diplomatike.

PZAP, në arsyetim të vendimit të lartcekur ndër të tjera ka theksuar se: Instituti Demokratik i Kosovës brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë në PZAP me datë 04.06.2026 kundër Vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve numër 01/1198-2026 të datës 03.06.2026 me të cilin vendim është miratuar rekomandimi për lejimin e votimit me dokumente identifikimi të Republikës së Kosovës me afat të skaduar të vlefshmërisë në qendrat e votimit në përfaqësi diplomatike, me pretendimin se është nxjerr në kundërshtim me Ligjin numër 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, përkatësisht nenit 90 i ligjit i cili përcakton se votuesi mund të votojë nëse identifikohet saktësisht në Listën e Votuesve dhe ofron njërin prej dokumenteve të vlefshme të identifikimit të lëshuar nga Republika e Kosovës. Tutje, ka pretenduar se KQZ përmes vendimit të kontestuar ka ndryshuar përmbajtën e dispozitës ligjore duke lejuar



përdorimin e dokumenteve me afat të skaduar ndonëse ligji kërkon dokumente të vlefshme identifikimi, dhe e njëjta nuk ka kompetencë që përmes një vendimi administrativ të ndryshojë apo të zgjerojë kushtet ligjore për ushtrimin e së drejtës së votës dhe se një veprim i tillë përbënë tejkalim të kompetencave të saj ligjore.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në përgjigje ndaj kësaj ankese të ushtruar në PZAP, ka propozuar refuzimin e ankesës si të pa bazuar duke theksuar se vendimi i kontestuar nuk ka krijuar të drejtë të re vote dhe nuk ka zgjeruar kategoritë e votuesve që gëzojnë të drejtën e votës, por ka pasur për qëllim garantimin e ushtrimit efektiv të së drejtës kushtetuese të votës nga shtetasit e RKS-së të regjistruar për votim në përfaqësi diplomatike.

Tutje, PZAP ka vlerësuar se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk ka pasur autorizim ligjor që përmes vendimit administrativ, votuesve jashtë Kosovës të ju lejoj votimin me dokument identifikimi të skaduar, në një situatë kur Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme kërkon shprehimisht paraqitjen e dokumenteve të vlefshme identifikimi. Konkretisht neni 90 paragrafi 1 i Ligjit numër 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme përcakton se për qëllim të zgjedhjeve, shtetasi me të drejtë vote brenda vendit dhe në përfaqësi diplomatike mund të votojë nëse identifikohet saktësisht në Listën e Votuesve dhe ofron njërin prej dokumenteve të vlefshme të identifikimit të lëshuara nga Republika e Kosovës përkatësisht letërnjoftimin, pasaportën ose lejen e vozitjes.

Sipas PZAP kjo dispozitë është e qartë dhe nuk lejon dualizëm në interpretimin që do ta barazonte dokumentin e vlefshëm me dokumentin me afat të skaduar. Ashtu që ligji nuk ka përdorur vetëm termin “dokument identifikimi” por shprehimisht ka kërkuar “dokumente të vlefshme identifikimi”

KQZ ka parashtruar përgjigje në ankesën e ushtruar nga Instituti Demokratik i Kosovës ndaj tyre në PZAP dhe ndër të tjera kanë theksuar se: gjatë fazës së regjistrimit të votuesve jashtë Kosovës, ka lejuar që aplikues të caktuar të regjistrohen duke paraqitur dokumente të identifikimi me afat të skaduar, mirëpo PZAP ka vlerësuar se kjo rrethanë në asnjë mënyrë nuk mund të interpretohet me automatizëm si e drejtë për të votuar me dokument të skaduar në ditën e votimit, ngase procedura e regjistrimit të votuesve dhe procedura e votimit janë dy faza të ndryshme të procesit zgjedhor, ashtu që regjistrimi ka për qëllim verifikimin paraprak të të drejtës së një personi për t’u përfshirë në Listën e Votuesve, ndërsa votimi është faza përfundimtare e ushtrimit të së drejtës së votës, ku ligji kërkon identifikim me dokument të vlefshëm të votuesit në momentin e paraqitjes në vendvotim ditën e votimit pavarësisht se ku voton votuesi, brenda apo jashtë vendit. Po ashtu, përfshirja e një personi në Listën e Votuesve nuk e përjashton detyrimin që ai person në ditën e votimit t’i plotësojë kushtet e përcaktuara shprehimisht me ligj.

Kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Gjykatën Supreme, ka paraqitur ankesë anëtarja e KQZ-së, Violeta Salihu, dhe ndër të tjera ka theksuar se: KOZ me vendimin numër 01/1198-2026 të datës 03.06.2026 ka miratuar rekomandimin për lehtësim të



votimit në Qendrat e Votimit në Përfaqësitë Diplomatike të Republikës së Kosovës me dokumente identifikimi të Republikës së Kosovës, afati i vlefshmërisë së të cilit ka skaduar. Ky vendim është nxjerrë në kuadër të administrimit të procesit zgjedhor për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 07.06.2026 dhe ka pasur për qëllim garantimin e ushtrimit efektiv të së drejtës së votës për qytetarët e Republikës së Kosovës të cilët janë regjistruar paraprakisht si votues në përfaqësitë diplomatike. Tutje, ka shtuar se PZAP ka interpretuar gabimisht nenin 90 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme sepse e ka reduktuar tërë çështjen në vlefshmërinë formale të dokumentit të identifikimit, pa e analizuar funksionin partiak që ky dokument kryen në procesin zgjedhor, dhe qëllimi i këtij neni është identifikimi i saktë i votuesit dhe garantimi që të drejtën për votë të mund ta ushtroj personi që figuron në listën e votuesve. Si dhe në asnjë vend demokratik me sundim të theksuar të ligjit, mungesa e vlefshmërisë së mjetit identifikues nuk eliminon të drejtën e votimit si garancion kushtetues.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur PZAP-i, përmes të cilës kundërshton pretendimet ankimore dhe propozon që ankesa e parashtruar nga Violeta Salihu, anëtare e KQZ-së, të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas ankesës së parashtruar nga ankuesja, si dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, e duke u mbështetur në nenin 80 paragrafi 3, pika 3.1 dhe 3.3 të Ligjit për Konfliktet Administrative Nr.08/L-182, lidhur me nenin 118 paragrafi 4 të Ligjit nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, gjeti se:

Ankesa është e **palejuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se PZAP-i me vendimin e kontestuar ZP.Anr.19/2026 të datës 05.06.2026, e ka aprovuar si të bazuar ankesën e parashtruar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) me numër ZP.Anr.19/2026 dhe e ka anuluar vendimin e KQZ-së, Nr.01/1198/2026 i datës 03.06.2026, lidhur me Miratimin e Rekomandimit për Lejimin e Votimit me Dokumente të Republikës së Kosovës, me afat të skaduar të vlefshmërisë për votim në Qendrat e Votimit për Përfaqësitë Diplomatike.

Kundër vendimit të PZAP-së, Violeta Salihu, anëtare e KQZ-së, ka paraqitur ankesë dhe ka kërkuar që të aprovohet ankesa e KQZ-së, si e bazuar, të ndryshohet vendimi i kontestuar i PZAP-së dhe të mbetet në fuqi vendimi Nr.01/1198/2026 i datës 03.06.2026 i KQZ.

Gjykata Supreme e Kosovës, në këtë çështje juridike fillimisht vlerësoi lejueshmërinë e ankesës në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe konstatoi se në këtë rast ankesa është e palejuar.

Në lidhje me këtë, me nenin 118 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përcaktohet se: "1. PZAP-ja pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht. 2. PZAP-ja ofron bazat ligjore dhe faktike për vendimet e tij me shkrim. PZAP-ja u ofron kopjet e vendimeve të tij me shkrim, palëve të përfshira, brenda afatit prej shtatëdhjetë e dy (72) orëve nga momenti i dorëzimit të ankesës në rast se ai ndikon në certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve. Për



vendimet tjera PZAP-ja ofron kopjet e vendimeve të tij me shkrim, palëve të përfshira në çështje, brenda pesë (5) ditëve kalendarike. 3. Vendimet e PZAP-së publikohen në përputhshmëri me rregullat dhe procedurat e PZAP. 4. Vendimi i PZAP-së mund të ankimohet në Gjykatën Supreme të Kosovës, sikurse që PZAP-i mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar. Ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda dyzet e tetë (48) orëve nga pranimi i vendimit të PZAP-së, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë se pesë mijë euro (5.000 €), ose në rast se çështja lidhet me një të drejtë themelore. Gjykata Supreme e Kosovës vendos në afatin prej pesë (5) ditësh nga paraqitja e ankesës. 5. Vendimi i PZAP-së është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga KQZ-ja, përveç nëse Gjykata Supreme e Kosovës vendos ndryshe”.

Në vijim të kësaj, me dispoziten e nenit 119 paragrafi 1 të po të njëjtit ligj, shprehimisht parashihet se: “1. Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-së, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të parashtrijë ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit dhe PZAP vendos për ankesën brenda nëntëdhjetë e gjashtë (96) orëve nga parashtrimi i saj”. Ndërsa në zbatim të kësaj dispozite dhe nenit 115 dhe 117 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, PZAP me Rregulloren Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave, e miratuar me 24.07.2025, përkatësisht në nenin 4 të saj, ka paraparë në mënyrë taksative se kush ka të drejtën e parashtrimit të ankesës në PZAP, të cilët pastaj kanë të drejtë që kundër vendimit të PZAP, të parashtrijnë edhe ankesë në Gjykatën Supreme.

Si rrjedhojë, Kolegji i Gjykatës Supreme vlerëson se ankesa e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) është e palejuar, për shkak të mungesës së legjitimitetit aktiv procedural të parashtrueses së ankesës.

Nga shkresat e lëndës rezulton se ankesa në Gjykatën Supreme është paraqitur nga Violeta Salihu anëtare Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Megjithatë, sipas vlerësimit të këtij Kolegji, një anëtar individual i KQZ-së nuk gëzon të drejtë të pavarur procedurale për të ushtruar mjete juridike në emër personal kundër vendimeve të PZAP-së, përderisa nuk është palë e drejtpërdrejtë në procedurën administrative apo zgjedhore dhe nuk dëshmon ekzistimin e një interesi juridik personal e të drejtpërdrejtë të cenuar me vendimin e kontestuar.

Kolegji thekson se e drejta e ankimit në Gjykatën Supreme kundër vendimeve të PZAP-it është e rregulluar shprehimisht me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme. Sipas nenit 119 të këtij ligji, legjitimitetin për paraqitjen e ankesës e kanë personat që dëshmojnë interes juridik në çështjen konkrete, si dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përkatësisht institucioni si organ kushtetues dhe administrativ i autorizuar me ligj. Nga përmbajtja dhe qëllimi i kësaj dispozite nuk rezulton se ligjvënësi ka paraparë të drejtën e ushtrimit të ankesës për secilin anëtar individual të KQZ-së në emër të vet, jashtë vullnetit institucional dhe përfaqësimit zyrtar të këtij organi.

Në këtë drejtim, Kolegji vlerëson se KQZ-ja ushtron kompetencat e saj si organ kolegjal, ndërsa anëtarët e saj marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes brenda institucionit përmes votimit dhe shprehjes së qëndrimeve të tyre gjatë shqyrtimit të çështjeve që bien në



kompetencën e këtij organi. Megjithatë, fakti i pjesëmarrjes në procesin vendimmarrës nuk krijon automatikisht cilësinë e palës në procedurën gjyqësore dhe as të drejtën për të vepruar individualisht në emër të institucionit ose në emër personal kundër një vendimi që i drejtohet institucionit.

Pranimi i një interpretimi të kundërt do të çonte në zgjerimin e rrethit të subjekteve të autorizuar për ushtrimin e mjeteve juridike përtej asaj që është paraparë shprehimisht nga ligji, duke mundësuar që secili anëtar individual i një organi kolegjal të kontestojë vendime në mënyrë të pavarur, edhe kur institucioni si tërësi nuk ka vendosur të ndërmarrë një veprim të tillë. Një qasje e tillë do të ishte në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë, sigurisë juridike dhe funksionimit institucional të organeve kolegjiale.

Për këto arsye, Kolegji i Gjykatës Supreme konstaton se ankuesja, në cilësinë e anëtares individuale të KQZ-së, nuk posedon legjitimitet aktiv për paraqitjen e ankesës kundër vendimit të PZAP-it, rrjedhimisht ankesa e paraqitur prej saj është e palejuar dhe si e tillë duhet të hidhet poshtë.

Si rezultat i kësaj, Kolegji i Gjykatës Supreme vlerëson se ankuesja nuk gëzon cilësinë e palës në procedurën e zhvilluar para Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), e rrjedhimisht nuk posedon as legjitimitet aktiv procedural për paraqitjen e ankesës në Gjykatën Supreme, kundër vendimit të këtij organi.

Kjo për faktin se objekt i shqyrtimit para PZAP-it, ka qenë kontrolli i ligjshmërisë së një akti administrativ, përkatësisht i vendimit të nxjerrë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) në ushtrimin e kompetencave të tij ligjore si organ kolegjal. Për pasojë, subjekt i vlerësimit nga PZAP-i ka qenë vetë vendimi institucional i KQZ-së dhe jo veprimet apo të drejtat individuale të anëtarëve të saj.

Në këtë kuptim, ankuesja, në cilësinë e anëtares së KQZ-së, nuk paraqitet si palë me interesa të veçanta në raportin juridik që është objekt i procedurës, por si pjesë përbërëse e organit kolegjal që ka nxjerrë vendimin, ligjshmëria e të cilit është vlerësuar nga PZAP-i në ushtrimin e kompetencës së tij të përcaktuar me nenin 115 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Vetë pjesëmarrja në procesin e vendimmarrjes së një organi kolegjal nuk krijon për anëtarët e tij një të drejtë të pavarur procedurale për të kundërshtuar në gjykatë vendimet që kanë të bëjnë me institucionin si tërësi.

Kolegji vlerëson se e drejta individuale e anëtarit të KQZ-së, realizohet dhe shterohet brenda mekanizmave të vendimmarrjes së këtij organi, përmes pjesëmarrjes në debat, ushtrimit të së drejtës së votës dhe, sipas rastit, evidentimit të mendimit kundërshtues apo të veçantë në procesverbal. Megjithatë, këto të drejta nuk mund të interpretohen si bazë ligjore për krijimin e një legjitimiteti të veçantë procedural, i cili do t'i mundësonte anëtarit individual të KQZ-së të paraqitej si palë në procedurë gjyqësore dhe të kundërshtonte personalisht një vendim të PZAP-it që ka të bëjë me ligjshmërinë e një akti institucional të KQZ-së.



Për më tepër, nga përmbajtja e vendimit të kontestuar nuk rezulton se ankueses personalisht, i është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik individual i mbrojtur me ligj. Vendimi i PZAP-it nuk prodhon pasoja juridike të drejtpërdrejta ndaj statusit, të drejtave apo detyrimeve të saj individuale, por ka të bëjë ekskluzivisht me vlerësimin e ligjshmërisë së një vendimi të nxjerrë nga KQZ-ja si institucion.

Për këto arsye, Kolegji i Gjykatës Supreme konstaton se ankesa e paraqitur nga ankuesja është e palejuar, për shkak të mungesës së legjitimitetit aktiv procedural për ushtrimin e saj.

Meqenëse në rastin konkret nuk janë përmbushur kushtet procedurale të parapara me ligj për shqyrtimin e ankesës, Gjykata nuk mund të kalojë në shqyrtimin e themelësisë së pretendimeve ankimore.

Rrjedhimisht, duke qenë se ankuesja nuk e ka cilësinë e palës së autorizuar për paraqitjen e ankesës kundër vendimit të PZAP-së, Kolegji nuk është lëshuar në vlerësimin meritot të çështjes së ngritur me ankesë, respektivisht në shqyrtimin e pretendimeve lidhur me ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, por ka vendosur vetëm mbi lejueshmërinë procedurale të mjetit juridik të ushtruar.

Nga të cekurat më lartë dhe në bazë të nenit 80 paragrafi 3, pika 3.1 dhe 3.3 të Ligjit për Konfliktet Administrative, lidhur me nenin 118 paragrafi 4 të Ligjit nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

AA.nr.26/2026 me datë 11.06.2026

Kryetare e kolegjit,
Delushe Halimi



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik